



Zgjidhje për mbrojtjen

Pemë frutore bërthamore
pjeshkë, nektarinë, kumbull,
qershë dhe kajsi



Zgjidhje për mbrojtjen

Pemë frutore bërthamore

pjeshkë, nektarinë, kumbull,
qershi dhe kajsi

Dëmtuesit

Afidet

PROBLEMI

Pemët frutore bërthamore preken zakonisht nga një numër i madh afidesh. Pjeshka dhe nektarina janë të ndjeshme ndaj shumë specieve të afideve (Myzus, Brachycaudus, Hyalopterus ecc.), qershia preket pothuajse vetëm nga Myzus cerasi, specie të ndryshme prekin kumbullën dhe më pak preket kajsia. Për luftimin me sukses të tyre, është i rëndësishëm identifikimi i saktë, sepse çdo specie ka veçoritë e saj biologjike (numrin e breznive, stadin e dimërimit, ciklin e zhvillimit, bimët pritëse primare e sekondare, kohën e shfaqjes), simptomat dhe demin (kolonitë



MOVENTO[®]
100 SC

Koha: pas lulëzimit

Doza: 150 ml/100 l ujë (1,5-2.2 L/ha)

caLypso[®]

Koha: para, gjatë dhe pas lulëzimit

Doza: 30 ml/100 L ujë

Confidor[®]
200 SL

Koha: pas lulëzimit

Doza: 50 ml/100 L ujë

Përqëndrohu në:

MOVENTO

Movento është insekticidi i vetëm me veprim sistemik të dyfishtë; lëviz në drejtimin lart dhe poshtë. Movento, në sajë të lëvizjes së dyfishtë hyn në sistemin e qarkullimit dhe arrin në të gjitha organet e bimës: gjethe të reja dhe të zhvilluara, sytha, fruta dhe madje edhe rrënjë. Movento është produkti ideal për të mbrojtur frutat nga afidet sepse ka një mekanizëm

Dëmtuesit


Breshkëzat

PROBLEMI

Pemët frutore preken nga breshkëza të ndryshme. Më të rëndësishme janë :

- Breshkëza e Kalifornisë (Quadraspidiotus perniciosus), e cila prek pemët frutore bërthamore e farore. Ka 3 brezni në vit.
- Breshkëza e bardhë e pjeshkës (Pseudaulacaspis pentagona) që prek kryesisht pemët frutore bërthamore. Ka 2-3 brezni në vit.

Dëmi shkaktohet nga shpimet gjatë ushqimit. Prekjet shkaktjnë tharje, dëmtim të degëve dhe njolla të kuqe në fruta.



MOVENTO®
100 sc

Koha: Pas lulëzimit, me fillimin e migrimit të larvave të reja

Doza: 150ml/100 L ujë (1.5-2.2 L/ha)

Shënim: Mund t'i shtohet edhe vaj mineral



Këpushat

PROBLEMI

Këpushat më të dëmshme për pemët frutore bërthamore i përkasin familjes tetranikide (Panonychus ulmi, Tetranychus urticae) .

Dëmi shkaktohet nga boshatisja graduale e parenkimës së gjetheve si rezultat i thithjes nga këta dëmtues. Gjethet marrin ngjyrë bronxi dhe dëmtohet prodhimi në sasi e cilësi. Për mbajtjen nën kontroll të këtyre dëmtuesve, është thelbësore ruajtja e armiqve të tyre natyrorë.

enviDOR®
240 SC

Koha: Me shfaqjen e stadeve të para të lëvizshme

Doza: 600 ml/ha

Shënim: Lufton edhe breshkëzat

Dëmtuesit



Cidia molesta

PROBLEMI

Është dëmtuesi "kyç" për pjeshkën, por prek gjithashtu edhe bërthamoret e tjera, si dhe farorët e bimët zbukuroese (trëndafilat). Ka 4-5 brezni në vit. Fluturimi i parë i insektit të rritur fillon në pranverë dhe arrin pikun në fund të prillit - fillim i majit. Larvat e breznisë së parë prekin kryesisht lastarët, kurse ato të brezive pasardhëse kryesisht frutat. Prekje të mëdha mund të vërehen gjithashtu në farorë në kohën e pjekjes së frutave.

ZGJIDHJA !

Mbrojtja duhet bazuar në monitorimin e popullatës me kurthe seksuale. Momenti i ndërhyrjes ndryshon në varësi të produktit të përdorur dhe mbrojtja mund të integrohet me metodën e konfuzionit seksual.



Koha: nga fillimi i fluturimit, deri në fillim të vendosjes së vezëve

Doza: 40-50 ml/100 L ujë (0,4-0,5 L/ha)

Cidia funebrana

PROBLEMI

Është dëmtues "kyç" për pjeshkën, por mund të prekë edhe pemët e tjera bërthamore. Ka 1 deri në 3 brezni, në vartësi të zonës së shpërndarjes . Fluturimi fillon nga mesi i prillit deri në fillimin e majit. Larva penetron shpejt në frutat e vegjël të cilët mund të bijen. Breznitë pasardhëse shkaktojnë dëme të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë si kalbëzimin gri.

caLypso®

Koha: fillimi i çeljes së vezëve

Doza: 25 ml/100 L ujë

Shenim: Efektiv edhe ndaj tenjës (*Anarsia lineatella*)



Dëmtuesit

Tenja e pjeshkës (*Anarsia lineatella*)

PROBLEMI

Ka tre brezni në vit. Dëmet e para duken me fillimin e vegjetacionit kur larvat që dalin nga mbulesat dëmtojnë sythat. Dëmi është i ngjashëm me atë të *Cydia molesta* por ndodh 2-3 javë më shpejt.

Mizat

PROBLEMI

Janë dy lloje mizash që dëmtojnë bërthamorët:

- **Miza mesdhetare** (*Ceratitis capitata*) - prek pemë të ndryshme si kajsi, pjeshkë, kumbull, agrume dhe pemët frutore farore;
- **Miza e qershisë** (*Rhagoletis cerasi*) - prek kryesisht qershinë .

Larvat e të dy llojeve zhvillohen brenda tultit të frutave duke kompromentuar rritjen e tyre, cilësinë dhe tregëtimin.



calypso®

Koha: fillimi i çeljes së vezëve

Doza: 30 ml/100 L ujë



Koha: nga fillimi i fluturimit, deri në fillim të vendosjes së vezëve

Doza: 40-50 ml/100 L ujë (0,4-0,5 L/ha)

Tripset

PROBLEMI

Dëmtojnë lulet dhe frutat e vogla të nektarinës dhe kultivarët e pjeshkës me pak push në sipërfaqe. Toksinat që injektojnë me pështymën shkaktojnë deformime dhe dëmtime që më vonë nekrotizohen dhe tapëzohen. Frutat e nektarinës, për shkak të mungesës së pushit, janë më të ekspozuar. Dëmtimet shkaktohen duke filluar nga faza e butonit rozë deri në afërsi të pjekjes.

Llojet më të zakonshme janë Thrips meridionalis, Thrips major, Thrips tabaci dhe Frankliniella occidentalis; kjo e fundit dëmton kryesisht para vjeljes.

Confidor 200 SL

Koha: Para lulëzimit për luftimin e infeksioneve pranverore

Doza: 50 ml/100 L ujë



Semundjet

Monilia

Problemi

Kalbëzimi është një nga sëmundjet më serioze për drufrutorët. Dy kërpudhat përgjegjëse, *Monilinia laxa* dhe *Monilinia fructigena*, kanë karakteristika të ngjashme, edhe pse e para mbizotëron në fillimin e vejetacionit me prekjet e lastarëve, gjethëve, sytheve, luleve, ndërsa e dyta më shpesh në fruta . Lulet e prekura thahen dhe marrin ngjyrë kafe, gjethet vyshken, thahen dhe mbeten të ngjitura në lastarë të cilët, nëse janë infektuar, thahen pasi çahen dhe krijojnë një rrjedhje si gomë. Frutat mund të preken si në fillim të zhvillimit, ashtu edhe në pjekje: në të dyja rastet kalben dhe mbulohen me myk. Pasojat e prekjes në fushë shfaqen edhe pas vjeljes, në ruajtje dhe gjatë tregëtimit.

ZGJIDHJA

Mbrojtja në fushë në fazën para vjeljes, por në kohë shumë të lagësht dhe me shi, duhet të merren masa për mbrojtjen e bimëve edhe në fazën e lulëzimit.

Përqëndrohu në:

LUNA EXPERIENCE

Luna Experience bazuar në Tebuconazole dhe Fluopyram, është një fungicid i ri me spektër të gjërë për luftimin e sëmundjeve në shumë kultura frutore. Fluopyram është një lëndë e re aktive për luftimin e sëmundjeve të pemëve frutore, e cila sulmon kërpudhat nga mbirja e sporeve deri në sporulim. Luna Experience mund të përdoret deri 3 ditë para vjeljes, duke siguruar kontrollin maksimal të sëmundjet që zhvillohen në fushën e atyre që zhvillohen gjatë fazës së ruajtjes, duke siguruar prodhimin e më shumë frutave dhe ruajtjen e cilësisë së tyre.



Luna
EXPERIENCE

Koha: fillimi i lulëzimit, para vjeljes

Doza: 0,6-0,75 L/ha

TELDOR

Koha: 1-2 trajtime në lulëzim, 1-2 trajtime deri 2 javë para vjeljes

Doza: 1 - 1,5 L/ha

Sëmundjet

Hiri

Problemi

Sëmundja prek lastarët, gjethet dhe frutat. Favorizohet sidomos nga klima e ngrohtë, me lagështi, por kufizohet nga shirat dhe lagështia e zgjatur në bimë. Ajo dallohet nga miceli karakteristik i bardhë mbi indet e prekura. Shkaktojnë më shumë dëme kur infektimet janë të hershme. Shkalla e prekjës varet nga ndjeshmëria e kultivarit .

Veçanërisht të ndjeshme janë nektarinat dhe pjeshkët.

ZGJIDHJA

Për mbrojtjen nga hiri duhet të merret në konsideratë ndjeshmëria e kultivareve dhe niveli i rrezikut në zonë.

Në zonat më të përshtatshme për zhvillimin e hirit, duhen bërë trajtime parambrojtëse duke filluar pas lulëzimit (rënia e kurorës së lules) dhe fillimit të rritjes së frutit.



Luna
EXPERIENCE

Koha: trajtime parambrojtëse

Doza: 0.5 L/ha

Shënim: I efektshëm edhe ndaj kalbëzimit

NATIVO 
75 WG

Koha: trajtime parambrojtëse

Doza: 20 g/100 L ujë (300 g/ha)

Shënim: I efektshëm edhe ndaj kalbëzimit

Folicur EW 250

Koha: trajtime parambrojtëse ose me shfaqjen e simptomave të para

Doza: 50 - 60 ml/100 L ujë

Shënim: I efektshëm edhe ndaj kalbëzimit



Sëmundjet

Gjethepërdredhësja

PROBLEMI

Gjethepërdredhësja (*Taphrina deformans*) prek kryesisht gjethet e pjeshkës ku dëmi është më i dukshëm, por edhe lulet, frutat dhe lastarët. Simptomat e para shfaqen në gjethe ku krijohen fryrje të cilat rriten në vëllim. Indet i përtrofike ndryshojnë ngjyre, shkatërrohen dhe rrëzohen.

Gjethet e sëmura duken të ndritshme për shkak të modifikimit morfologjik të indeve të prekura.

Përhapja e çrregullt e indeve meristematiqe shkakton deformim të gjetheve, të lastarëve dhe më pak të frutave tek të cilët, në prekjet e rënda, formohen rritjet tipike që çojnë deri në rrëzim të frutave.



NATIVO 
F.A.G.

Koha: trajtime parambrojtëse me fillimin e rritjes vegetative

Doza: 20 g/100 l ujë (300 g/ha)

Ndryshku

PROBLEMI

Është një kërpudhë që e plotëson ciklin e saj jetësor në dy bimë të ndryshme pritëse; një stad në disa bimë të egra të gjinisë *Ranunculus*, ndërsa stadin tjetër në bimë të gjinisë *Prunus* (kumbull, kajsji, pjeshkë dhe bajame). Shfaqet në verë dhe dëmet janë të kufizuara në gjethe ku krijohen pustula kafe mbi pjesën e poshtme.

Në vite me shira të zgjatur në pranverë mund të ndodhin infeksione të hershme jo vetëm në gjethe por edhe në fruta dhe lastarë.

Trajtimi është thelbësor në kumbulla (kultivarë evropianë), me shfaqjen e pustulave të para në fund të qershorit dhe në fund të korrikut - fillimi i gushtit.



Folicur 
EW 250

Koha: trajtime parambrojtëse ose me shfaqjen e simptomave të para

Doza: 50 - 60 ml/100 L ujë

Barërat
e këqija



Barërat dhe thithakët

PROBLEMI

Luftimi i mirë i barërave të këqija dhe thithakëve në pemëtore është një praktikë e rëndësishme për të siguruar rritjen optimale vegjetative të pemëve dhe kufizimin e efektit konkurrues të tyre.

ZGJIDHJA

Bëhen trajtime në vjeshtë për të kontrolluar barërat e këqija në rreshta për të gjithë periudhën e dimrit. Efekti i mulçerimit, që sigurohet nga tharja progresive e barërave të këqija, pengon mbirjen e hershme të barërave të këqija në pranverë.

b a s t a

Koha: trajtime pranverore e verore si dhe trajtime në vjeshtë

Doza: 5 - 7.5 L/ha

Shenim: Maksimumi 2 trajtime në vit

Vazhdohet në pranverë me trajtim për luftimin e barërave të këqija graminore e gjethegjëra një, dy e shumëvjeçare si dhe për tharjen e thithakëve. Kjo ndërhyrje, nëse është e nevojshme, mund të përsëritet gjatë verës.

Përqëndrohu në:

BASTA - 15

Me një trajtim të vetëm me Basta-15 mund të luftohen barërat e këqija graminore e dykotiledone si dhe thithakët. Basta-15 duhet të përdoret në rreshtin e pemëve ose rreth pemëve të veçanta, duke përdorur sprucatorë të përshtatshëm për të evituar rënien e solucionit spërkatës mbi pjesët e gjelbra të pemëve.



Programi për pjeshkën dhe nektarinën



TELDOR® TELDOR®



envyidor®

caLypso®



decis® envydor®

MOVENTO®



Programi për qershinë e vishnjën

55		59		61_64		65_67		72		75		81_85		87	
----	--	----	--	-------	--	-------	--	----	--	----	--	-------	--	----	--

Luna[®]
EXPERIENCE

Luna[®]
EXPERIENCE

NATIVO[®]
75 WG

Luna[®]
EXPERIENCE TELDOR[®]


decis[®]

MOVENTO[®]

calypso[®]

Programi për kumbullën



- Monilia laxa
- Monilia fructigena



- Grerëzat e kumbullës
 - Afidet e gjetheve
 - Këpushat

Zgjidhje për mbrojtjen e bërthamoreve

Shënime

A series of 19 horizontal dashed lines for taking notes.



Bayer CropScience